



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

KAB

**URDHËR**

Nr. 16, datë 13.1.2021

**PËR**

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË MINISTRISË  
SË BRENDSHME**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

**URDHËROJ:**

1. Struktura e Ministrisë së Brendshme të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Ministrisë së Brendshme të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Ministrisë së Brendshme të jetë, gjithsej, 171 veta.
4. Urdhri nr.45, datë 9.3.2018, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Brendshme", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

